

KËRKESË
Nr. 111/9, datë 20.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i hapësirave pranë kopshtit në fshatin Fushë, Njësia Administrative Topojë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “tokë truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasurinë e llojit “ndërtesë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 133 614 (një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e katërbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARIT, PASURIA E TË CILIT PREKET NGA
REALIZIMI I PROJEKTTIT “REHABILITIM I HAPËSIRAVE PRANË KOPSHTIT NË
FSHATIN FUSHË, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, FIER”

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e prekur ndërtesës (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lek)	Vlera e përgjith. (lek)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Ramazan Ismail Hoxha	1655	73/20	142.41	60%	1.082.062	1.133.614	Konfirmim nga ZVRPP-ja më datë 8.11.2018, pajisur me certifikatë vërtetimi pronësie, datë 30.5.2005.
2	Shtet	1655	3 8/16	-	-	-	-	Konfirmim nga ASHK-ja, Drejtoria Fier, më datë 8.4.2022.
							1.133.614	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik”, dhe të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.